

**BLUEWE**Co-funded by the
Erasmus+ Program
of the European UnionREPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORENr. 322 ProtVlorë më 04/06/2021

Lënda: Relacion mbi krijimin e qendrës "Inovacion dhe Sipërmarrje" në Universitetin e Vlorës, në kuadër të projektit BLUEWBC.

REKTORIT

Prof. Dr. Roland ZISI

I nderuar Z. Rektor,

Në vijim të punës për implementimin e projektit "*Zhvillimi i qëndrueshem i Ekonomive Blu përmes arsimit të lartë dhe inovacionit në vendet e ballkanit perëndimor- BLUEWBC*", ku një nga qëllimet praktike të këtij projekti është krijimi i Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje në Universitetin e Vlorës, i cili do të shoqërohet me prokurimin e planifikuar të pajisjeve të sofistikuar në shumën **95,000 €**, që do të shërbejnë për të kryer punë kërkimore - shkencore dhe profesionale, zhvillim leksionesh dhe trajnimesh në mënyrë që të zhvillojë konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës (Lifelong Learning LLL), ju përcjellim më posht një realcion mbi krijimin e kësaj qendre. Nisur nga filozofia dhe qëllimet kryesore të kësaj qendre, duke patur parasysh dhe strukturën e UV-së propozojmë si mjaft të përshtatshme që kjo qendër ti atashohet Qendrës së Zhvillimit Rajonal në UV.

Bashkëlidhur: Relacioni mbi krijimin e Qendrës për Inovacion dhe Sipërmarrje në UV.

Koordinator Projekti

Prof. Asoc Kristofor Lapa

RELACION MBI KRIJIMIN E QENDRËS I&E NË UNIVERSITETIN E VLORËS

Zhvillimi WP 3: Krijimi i qendrave të I&E (Inovacionit dhe Sipërmarrjes) në IAL (Institucionet e Arsimit të Lartë) malazeze dhe shqiptare

- 3.1 Blerja e pajisjeve të reja dhe azhurnimi i pajisjeve ekzistuese _ 02.2021
- 3.2 Instalimi dhe testimi i pajisjeve _ 06.2021
- 3.3 Krijimi i mjediseve për qendrat e I&E në IAL-të e vendeve patnere _ 07.2022

1. Hyrje

Universiteti i Vlorës, Shqipëri është një institucion partner në projektin Erasmus +, të titulluar "**Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomive BLU përmes arsimit të lartë dhe inovacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor (BLUEËBC)**". Ky projekt u pranua për financim nga Executive Agency for Education, Audiovisual Policy and Culture of the European Union (Agjencia Zbatuese për Arsimin, Politikën Audiovizive dhe Kulturën e Bashkimit Evropian (EACEA)) nën Aksin 2 - Bashkëpunimi për Inovacionin dhe Shkëmbimin e Praktikave të Mira - Ndërtimi i Kapaciteteve në Arsimin e Lartë. Projekti koordinohet nga Universiteti i Shkencës dhe Teknologjisë i Norvegjisë (NTNU), Shkolla e Mesme Alesund (Norvegji). Projekti filloi në 15 Janar 2020 dhe do të zgjasë për tre vjet. Buxheti i përgjithshëm i projektit është **985 755,00 €** dhe ndahet midis 10 partnerëve pjesëmarrës, prej të cilit buxheti për Universitetin e Vlorës është **184.991,00€**.

Gjatë periudhës tre-vjeçare të zbatimit të projektit BLUEËBC, partnerët e BE-së dhe jo-BE që do të angazhohen, janë: Fakulteti i Studimeve Detare të Universitetit të Malit të Zi (Mali i Zi), Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" (Shqipëri), Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës (Shqipëri), Universiteti i Splitit (Kroaci), Universiteti Teknik Vilnius Gediminas (Lituani), Qendra e Trajnimit Detar NTNU - Ocean Training AS nga Alesund (Norvegji), Dhoma e Tregtisë e Malit të Zi (Mali i Zi), Administrata Detare Shqiptare Durrës (Shqipëri) dhe Qendra e Inovacionit dhe Sipërmarrjes Tehnopolis Niksic (Mali i Zi).

Qëllimet kryesore të projektit BLUEËBC janë hartuar për të përmirësuar situatën ekzistuese në fushën e Ekonomive Blu, Inovacionit dhe Sipërmarrjen përmes ndërtimit të kapaciteteve në Arsimin e Lartë, si dhe lidhjes së komunitetit akademik me industrinë. Faktorët kryesorë për arritjen e qëllimeve të synuara në projekt janë modifikimi i lëndëve ekzistuese dhe zhvillimi i lëndëve të reja në studimet universitare bachelor dhe master, si dhe krijimi i një mjedisi detar interesant, inovativ dhe dinamik, të gjitha këto me qëllimin për të tërhequr sa më shumë studentë të rinj dhe të talentuar, duke zhvilluar karrierat dhe motivimin e tyre dhe të stafit akademik që të ndjekin arritjet më të fundit dhe bashkëkohore në këtë fushë.

Një nga qëllimet praktike të këtij projekti është krijimi i Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje **në Universitetin e Vlorës**, i cili do të shoqërohet me

prokurimin e planifikuar të pajisjeve të sofistikuara në shumën **95,000 €**, që do të shërbejnë për të kryer punë kërkimore - shkencore dhe profesionale, zhvillim leksionesh dhe trajnimesh në mënyrë që të zhvillojë konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës (Lifelong Learning LLL).

Për të përmirësuar Ekonomitë Blu bazuar në inovacionin dhe sipërmarrjen në Mal të Zi dhe Shqipëri, është e nevojshme të punohet në lidhjen dhe shkëmbimin e përvojave pozitive dhe praktikave më të mira me BE dhe vendet e rajonit. Në përputhje me rrethanat, institucionet e arsimit të lartë në fushën e ekonomive Blu në këto vende të Ballkanit Perëndimor, kanë njohur dhe vlerësuar rëndësinë e lidhjes me institucionet e arsimit të lartë të njohura dhe me përvojë shumë të mirë, si dhe përfaqësues të industrisë nga BE dhe vendet e rajonit.

Në kuadër të Qendrës të krijuar për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje, do të realizohen aktivitetet e mëposhtme: pjesë të procesit mësimor, kërkime të thelluara dhe të aplikuara në fushën e ekonomive Blu, organizimi i takimeve shkencore dhe profesionale, monitorimi i zbatimit të rezultateve të kërkimit në studime dhe analiza praktike dhe shkencore.

2. Qëllimet dhe objektivat e Qendrës për Kërkim, Inovacion dhe Sipërmarrje

Qëllimet kryesore të Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje, janë:

- Kryerja e kërkimeve teknike-teknologjike të thelluara dhe të aplikuara shumëdisiplinare;
- Promovimi i burimeve kërkimore dhe inovative në Universitetin e Vlorës;
- Rrjetëzimi dhe ngritja e kapaciteteve kombëtare shkencore dhe profesionale (do të kryhen trajnime, shkolla verore, mësimi gjatë gjithë jetës - LLL).
- Bashkëpunim intensiv ndërkombëtar, pjesëmarrje dhe menaxhim i projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Multidisiplinariteti i kërkimit, bashkëpunimi intensiv me institucionet, promovimi dhe përdorimi i burimeve lokale në dispozicion;
- Promovimi shkencor dhe kulturor i Shqipërisë;
- Promovimi ndërkombëtar i identitetit detar të Shqipërisë dhe atraksioneve detare të rajonit;
- Nxitja e bashkëpunimit me industrinë, veçanërisht me përfaqësuesit e ekonomisë Blu;
- Zbatimi i konceptit të sipërmarrjes në sektorin detar;
- Sigurimi i mbështetjes në zhvillimin e inkubatorëve të biznesit brenda Universitetit të Vlorës.

3. Aktivitetet e Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje

Përmes Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje duhet dhe do të kryhen aktivitetet e mëposhtme:

- Mbledhja e të dhënave në lidhje me potencialet për kërkimin, sipërmarrjen dhe inovacionin në Universitetin e Vlorës;
- Kryerja e kërkimit teknik-teknologjik të thelluar dhe të aplikuar multidisiplinar;
- Zhvillimi i partneriteteve me kompani dhe lidhja e studiuesve/kërkuesve dhe studentëve me partnerët e biznesit;
- Sigurimi i mbështetjes dhe forcimi i lidhjeve me inkubatorët e biznesit, qendrat e inovacionit dhe sipërmarrjes, si dhe mjediseve (parqeve) të shkencës dhe teknologjisë.
- Pjesëmarrje e përbashkët në treg me njësitë e tjera që merren me transferimin e njohurive dhe teknologjisë në fushën e ekonomisë Blu;
- Sigurimi i qasjes në burime, pajisje, trajnime, rezultate të hulumtimeve, patentave dhe licencave të ofruara për mjedisin e biznesit;
- Organizimi i konferencave shkencore, seminareve;
- Kryerja e kërkimeve multidisiplinare, etj.

4. Hapsirat (godina) dhe pajisjet e Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje

Qendra për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje do të jetë pjesë e njësive të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrës (FSHNT) të Universitetit të Vlorës, Godina C, Kati 5. Përveç pajisjeve, simulatorëve dhe laboreve ekzistuese, në kuadër të projektit BLUEEBC do të prokurohen pajisje të reja moderne, të detajuara në tabelën mëposht:

Nr.	Emri	Përshkrimi	Link, prodhuesi	Sasia	Cmimi (për njësi)	Cmimi Total	Column 1
1	Azhornimi/perditesimi i simulatorit të dhomës së motorit		Transas/Wartsila	1	24.375,00 €	24.375,00 €	
2	Azhornimi/përditësimi i simulatorit të navigimit	Software dhe Hardware për 10 kompjuter, karta rrjeti dhe karta grafike	Transas/Wartsila	1	21.043,00 €	21.043,00 €	
3	GMDSS		Transas/Wartsila	1	4.625,00 €	4.625,00 €	
4	Bosch GLM400CL			3	200,00 €	600,00 €	
5	Instalimi i simulatorit			1	4.000,00 €	4.000,00 €	
6	3D Scanner	Artec Eva and RAC educational offer	Artec	1	14.000,00 €	14.000,00 €	
7	3D Printer	Original Prusa i3 MK3S 3D printer with kit	Prusa	6	800,00 €	4.800,00 €	
8	Kompjuter Desktop all in one		HP	6	1.000,00 €	6.000,00 €	
9	Laptop		HP	5	1.200,00 €	6.000,00 €	
10	Book scanner	Scan Book CZUR ET16 PLUS	CZUR	2	900,00 €	1.800,00 €	

11	Kindle Paperwhite Essentials Bundle	including a Kindle Paperwhite, 32 GB, with Special Offers, with Wi-Fi, an Amazon Leather Cover (Merlot) and an Amazon Powerfast 9W Power Adapter		11	200,00 €	2.200,00 €	
12	Projektor me rreze të shkurtër me smart table		Epson	2	2.700,00 €	5.400,00 €	
Sum					75.043,00 €	94.843,00 €	max. 95.000 €

5. Burimet njerëzore

Personeli mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës i Universitetit të Vlorës do të angazhohet brenda Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje sipas qëllimeve dhe aktiviteteve të përmendura më parë të Qendrës.

Përveç kësaj, brenda Qendrës do të angazhohen gjithashtu anëtarë të stafit me tema kërkimore në këto fusha, anëtarë nga institucionet partnere në kuadër të projektit BLUEWBC, si dhe të gjithë ekspertët në fushën e ekonomisë Blu. Duke qenë se kjo qëndër do të atashohet RDC-së, stafi i kësaj të fundit do të angazhohet gjithashtu për funksionimin e saj.

6. Qëndrueshmëria financiare

Në fazën e parë të zhvillimit të Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Sipërmarrje, të gjitha materialet e nevojshme dhe mjetet teknike / pajisjet dhe mbështetja financiare do të sigurohen kryesisht përmes projekteve ndërkombëtare dhe kombëtare, donacioneve, sponsorizimeve dhe partneriteteve me institucionet ndërkombëtare.

Është planifikuar që puna e mëtejshme e Qendrës do të financohet përmes shërbimeve të orientuara drejt tregut dhe të ardhurave të tjera të gjeneruara nga përdorimi i pajisjeve të prokuruar në kuadër të projektit BLUEWBC.

Koordinator Projekti

Prof. Asoc Kristofor Lapa

